



ПОДДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
МВЭСНТЕТЈЕ Е РЕФОРМАВЕ ЗГЈЕДНОРЕ

STUDIMI I
PJESËMARRJES SË GRAVE
NË PROCESET POLITIKE
NË MAQEDONINË E VERIUT

NJË PASQYRË E SHUMËLLOJSHME PËR

BARAZINË GJINORE NË KONTEKST

TË ZGJEDHJEVE LOKALE 2021



Kanë kaluar njëzet vjet nga vendosja e kuotës gjinore në kornizën ligjore të Maqedonisë së Veriut për zgjedhjet. Në këto dekada janë zbatuar më shumë se njëzet zgjedhje, ku më të fundit janë zgjedhjet lokale të tetorit 2021.

Përkundër përpjekjeve dhe iniciativave të shumta për të rritur pjesëmarrjen e grave në proceset zgjedhore të vendit dhe për të promovuar barazinë gjinore në shoqëri në tërësi, përfshirë dhe vendosjen e kuotës gjinore në vitin 2002, pjesëmarrja vazhdimisht e ulët e grave në proceset zgjedhore dhe politike në Maqedoninë e Veriut mbetet një nga pengesat më të mëdha për arritjen e barazisë gjinore dhe demokracisë së vërtetë.

Kjo përmbledhje paraqet gjetjet kryesore të një studimi të ri empirik mbi kufizimet e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe politike në Maqedoninë e Veriut. Studimi u ndërmor në kuadër të projektit Mbështetje për reformat zgjedhore në Maqedoninë e Veriut, i Agjencisë Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES).

Studimi mbledhi dhe analizoi të dhëna sasiore dhe cilësore nga një sondazh publik dhe diskutime në fokus grupe mbi këndvështrimet e qytetarëve, grave politike dhe përfaqësuesve të medias në lidhje me gratë në politikë. Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e studimit janë paraqitur më poshtë në formën e fragmenteve nga analiza e ekspertës.

Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë përmbledhje nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit, projektit ose zbatuesit.

Gjetjet e sondazhit



Interesi për politikën lokale, besimet dhe perspektivat mbizotëruese në lidhje me gratë në politikë

Të anketuarat femra shprehin pak më pak interes për politikën lokale (**43%**) sesa të anketuarit meshkuj (**48%**).



Vetëm 56 për qind e qytetarëve shprehin interes në çështjet e grave dhe pjesëmarrjen politike të grave në zgjedhjet lokale dhe kombëtare (**63%** e qytetarëve femra dhe **49%** e qytetarëve meshkuj).

89% **80%**

Qytetarët besojnë në barazinë e garantuar mes fermave dhe meshkujve si qytetarë

77% **67%**

Qytetarët besojnë në dyzet për qind pjesëmarrje për gratë në të gjitha nivelet e qeverisjes



88% **84%**

Qytetarët besojnë në mundësi të barabarta për gratë dhe burrat

72% **62%**

Qytetarët besojnë në zgjedhje me lista të kandidatëve që përputhen me kuotën gjinore, përkatësisht me katër kandidatë të një gjinie dhe gjashtë kandidatë të gjinisë tjetër

Në nivel lokal, gratë më të famshme/njohura janë ato aktive në:


- Politikë (politikane, aktiviste të partisë, anëtare të partisë): **20%**
- Pushtetin vendor (këshilltare komunale, kandidatë për këshilltare): **19%**
- Sektorin e shëndetësisë (mjeke dhe stomatologe): **16%**

Gjithsej **68 për qind** e femrave të anketuara u pajtuan se pritshmëritë më të larta janë vendosur mbi figurat publike femra, vetëm **47 për qind** e të anketuarve meshkuj janë pajtuar me këtë pohim.

Të anketuarit identifikuan faktorët e mëposhtëm si pengesat kryesore për pjesëmarrjen efektive të grave në procesin zgjedhor:

- Barra e dyfishtë mbi gratë që rezultoi nga pjesa e tyre joproporcionale e punës në familje dhe lindjes së fëmijëve (**43%**)
- Rolet tradicionale gjinore, stereotipet, qëndrimet dhe normat diskriminuese (**41%**)
- Mungesa e mbështetjes së partisë dhe përjashtimi nga strukturat vendimmarrëse të partisë (**38%**)



 **66%**  **59%**

Qytetarët besojnë se gratë dhe burrat nuk janë të paraqitur në mënyrë të barabartë në debate publike në përgjithësi.

 **62%**  **54%**

Qytetarët besojnë se gratë dhe burrat nuk ishin të pranishëm në mënyrë të barabartë në debatet publike gjatë zgjedhjeve lokale 2021.



Nivelet e ndërgjegjësimit për praninë e grave në proceset zgjedhore dhe politike

Kur u pyetën nëse më shumë kandidatë gra kishin marrë pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2021 sesa në zgjedhjet e mëparshme, **34 për qind** e të anketuarve meshkuj ishin dakord, ndërsa **60 për qind** e femrave të anketuara thanë se numri nuk ishte rritur.

Tre nga 10 qytetar janë në dijeni të grave që kryesojnë listën e kandidatëve të një partie në zgjedhjet e tyre komunale.

Gjysma e qytetarëve të intervistuar thonë se më pak se pesë nga 81 kryetarë të komunave të zgjedhur në secilën zgjedhje me radhë kanë qenë gra.

Shumica e të anketuarve identifikojnë faktorët e mëposhtëm si parakushte për rritjen e shtrirjes dhe cilësisë së përfaqësimit të grave në politikë:


- Një ndryshim mentaliteti (**78%**)
- Përpjekje thelbësore nga partitë politike për të përfshirë më shumë gra në partinë e tyre (**70%**)
- Programet e trajnimit dhe mentorimit të ofruara për gratë (**62%**)



Kur u pyetën nëse do të zgjidhnin një kandidat mashkull apo femër për kryetar komune nëse do t'u paraqitej një zgjedhje e dy kandidatëve po aq tërheqës, **65 për qind** e femrave të anketuara dhe vetëm **22 për qind** e meshkujve të anketuar thanë se do të zgjidhnin kandidatin gra.

Efektet negative të stereotipeve gjinore në perceptimet e qytetarëve për gratë pjesëmarrëse në jetën publike dhe për gratë udhëheqëse

Kriteret kryesore të aplikuara nga qytetarët në votimin për kandidatët burra dhe gra janë:



Gjetjet e fokus grupit



Perceptimet e përgjithshme të grave në politikë në Maqedoninë e Veriut

Sipas pjesëmarrësve të grupit të fokusit, duke përfshirë kandidatët gra, anëtarët e partisë dhe politikanët gra të zgjedhura, numri në rritje i grave në listat e kandidatëve është vetëm rezultat i ligjit që kërkon 40 për qind pjesëmarrje për gratë. Ndërsa partitë politike kryesisht përputhen me këtë kuotë, rrallë i vendosin gratë në krye të listave të kandidatëve.

Arsyet e numrit të pamjaftueshëm të grave në politikë

- Dominimi i meshkujve në politikë
- Rolet tradicionale gjinore në familje
- Stereotipet dhe paragjykimet lidhur me gratë
- Gjuha e urrejtjes në media.

Përzgjedhja e grave për listat e kandidatëve

- Nxitësi kryesor që gratë të bëhen kandidatë për këshilltare në komunë është atraktiviteti i programit të partisë, veçanërisht në lidhje me çështjet gjinore dhe përfshirjen e grave në vendimmarrjen e partisë.
- Mbështetja kryesore për kandidaturat e grave janë forumet e grave të partive politike, anëtarët e tjerë të partisë, anëtarët e familjes dhe partnerët.
- Sfidat kryesore që hasin gratë kandidatë janë “politika dhe kalkulimet e udhëheqjes së partisë” dhe dominimi mashkullor i përzgjedhjes përfundimtare dhe renditjes së listave të kandidatëve.


Nivelet e mbështetjes për praninë e grave në proceset zgjedhore dhe politike

✓ Nëse gratë janë kandidatë për kryetare komune apo në listën për këshilltar, **50 për qind e të anketuarave femra** do të votonin për atë parti politike, në krahasim me vetëm **25 për qind të qytetarëve meshkuj**.

✓ Ndërsa **79 për qind e qytetareve femra** janë në favor të rritjes së hapësirës për gratë në politikë në nivel lokal, **një në tre meshkuj të anketuar** janë kundër.

✓ Arsyeja kryesore e përmendur nga qytetarët për mbështetjen e rritjes së hapësirës për gratë në politikë ishte “nevoja për barazi gjinore, të drejta të barabarta dhe përparimin e demokracisë” (**19%**).


Vetëm tre për qind thanë se e mbështetën këtë sepse “gratë janë më të ndershme dhe transparente”, “të guximshme dhe luftëtare”, ose sepse “gratë kanë vizion dhe ide më të mira dhe janë më kreative dhe inovative”.



Arsyet më të rëndësishme të përmendura për mospërkrahjen e rritjes së hapësirës për gratë në politikë ishin mendimet se “politika është për burrat, jo për gratë” (**16%**), se gratë “nuk do të kishin kohë për punët e familjes dhe shtëpisë” (**13%**) dhe se “burrat janë më të aftë, më aktivë, më të qëndrueshëm dhe më vendimtarë” (**11%**).

Përvojat nga fushata

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra nga kandidatet gra:** takime të drejtpërdrejta me qytetarët (derë më derë); dhënia e fletushkave dhe materialeve promovuese; konferenca për shtyp
- **Mbështetja kryesore:** kolegët nga partia dhe forumet e grave të partive politike; partnerët dhe anëtarët e familjes; trajnimi në të folurit publik dhe në komunikimet me gazetarët
- **Sfidat:** gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale në lidhje me paraqitjen fizike të grave kandidatë; mungesa e trajnimit për paraqitje publike dhe marrëdhënie me mediat



Çfarë do të bënit ndryshe nëse do t'ju duhej të kandidonit përsëri në zgjedhje?

- ✓ “TREGOHUNI MË TË GUXIMSHME DHE MË AMBICIOZE”
- ✓ “JINI MË SPECIFIKE DHE MË TË QARTA NË SHPREHJEN E KËRKESAVE”
- ✓ “KINI VETËBESIM MË TË MADH DHE TË JENI MË PAK VETËKRITIKE”

Media dhe çështjet gjinore

- Ekziston nevoja për kontroll më të madh mbi mediat online dhe portalet e internetit ku është vërejtur një nivel më i ulët i llogaridhënies
- Nuk ka barazi dhe ndershmëri në mënyrën se si janë portretizuar burrat dhe gratë kandidatë politikë nga media
- Gratë janë shënjestra të lehta në media dhe karrierat e tyre politike janë të prekshme nga gjuha e urrejtjes që sulmon drejtpërdrejt moralin dhe dinjitetin e tyre
- Gjuha e urrejtjes në media dhe rrjete sociale i ka dekurajuar shumë gratë që të angazhohen publikisht dhe aktivisht në politikë, duke i bërë shpesh të braktisin karrierën e tyre politike
- Të gjithë faktorët e mësipërm kontribuojnë në përfaqësimin e pabarabartë të grave në debatet publike në fushatat zgjedhore



E përgjithshme: Gratë në politikë

Nën përfaqësimi politik i grave në Maqedoninë e Veriut si dhe mungesa e mjedisit të përshtatshëm për të mbështetur përpjekjen e grave për ndikim thelbësor politik mbeten sfida të rëndësishme të cilat kontribuojnë ndjeshëm në pabarazinë gjinore në shoqëri.

Megjithëse ka “solidaritet midis grave” në shoqëri, kjo nuk do të thotë gratë të votojnë për kandidatë gra. Ndërsa ka njohje dhe ndërgjegjësim publik për mungesën e qasjes së grave në pozita udhëheqëse në të gjitha fushat e shoqërisë, kjo mos-qasje nuk rezulton në mbështetjen e burrave për zbatimin e kuotave gjinore si mekanizëm për të mundësuar qasje më të mirë të grave në pozita udhëheqëse. Përkundrazi, ka rezistencë të konsiderueshme ndaj kuotave gjinore midis burrave.

Stereotipet gjinore dhe paragjykimet ndikojnë në përzgjedhjen e kandidatëve nga partitë dhe renditjen e grave në listat e kandidatëve për këshilltarë dhe propozimet e kandidatëve për kryetar komune. Stereotipet e tilla ndikojnë gjithashtu në zgjedhjet e votuesve, duke pasqyruar portretizimin e padrejtë të grave politike në media. Kjo padrejtësi rezulton edhe nga fokusi mediatik, për gra kandidatë, në statusin martesor dhe pamjen fizike të tyre në vend të pikëpamjeve dhe propozimeve të tyre politike.



Reforma zgjedhore dhe kuadri ligjor

Ka prova të mbështetjes së konsiderueshme publike për përfaqësimin politik të grave, veçanërisht si kryetare komune. Megjithatë, kësaj mbështetjeje dhe kërkesë nuk i janë përgjigjur në mënyrë të kënaqshme partitë politike.

Ky fakt i bazuar në prova duhet të theksohet si një arsye për të filluar rishikimet e sistemit zgjedhor, duke përfshirë demokracinë e brendshme të partisë, për të rritur numrin e grave të zgjedhura si kryetare komune.

Në sistemin e listave të mbyllura të aplikuara në zgjedhjet lokale për zgjedhjen e këshilltarëve komunal në Maqedoninë e Veriut, janë partitë politike ato që përcaktojnë renditjen e kandidatëve në fletëvotimin zgjedhor, ndërsa votuesit vetëm mund të miratojnë ose refuzojnë të gjithë listën pa asnjë mundësi të ndryshimit të rendit në të cilin u ndahen vendet kandidatëve.

Duhet të vendosen dispozita në Kodin zgjedhor për të siguruar përfaqësim të balancuar gjinor midis kryesueseve të listave të kandidatëve.

Duhet të prezantohet zbatimi i “sistem zinxhiri”, i cili kërkon që partitë në listat e tyre alternojnë ndërmjet kandidatëve gra dhe burra, në mënyrë që të arrihet përfaqësim më i drejtë dhe proporcional”.

Mungesa aktuale e rregullimit të komunikimeve politike dhe mungesa e përgjegjësisë për gjuhën e urrejtjes dhe/ose gjuhën diskriminuese në rrjetet sociale, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore, përkthehet drejtpërdrejt në një nivel më të lartë të cenueshmërisë së kandidatëve gra ndaj ekspozimit publik negativ.

Duhet të merren parasysh mënyrat e përmirësimit të rregullimit të aktiviteteve politike në internet, dhe sanksionimin e shpifjes dhe gjuhës së urrejtjes gjatë fushatave zgjedhore.

Partitë politike

Megjithëse partitë politike nënkruajnë kode të sjelljes para fushatave zgjedhore, në praktikë ato zakonisht nuk arrijnë të adresojnë rastet e sjelljes së keqe ndaj grave nga ana e anëtarëve të tyre ose për t'i mbrojtur gratë kandidate nga gjuha e urrejtjes.



Të gjitha partitë politike duhet të miratojnë ose përmirësojnë kodet e tyre ekzistuese formale të sjelljes për të siguruar rregullim më efektiv të sjelljes së anëtarëve të partisë, përfshirë sjelljen e keqe ndaj grave. Të gjitha kodet e sjelljes duhet të përfshijnë detajet e procedurës dhe sanksionet që do të zbatohen në rastet e sjelljes së keqe.

Të dhënat e mbledhura nga studimi dhe diskutimet e grupeve të fokusit konfirmojnë perceptimin e përhapur se gratë politike në Maqedoninë e Veriut nuk kanë mbështetje të mjaftueshme nga partitë e tyre politike. Në veçanti, gratë përballen me pengesa në formën e mungesës së mbështetjes nga liderhipi i partive i mbizotëruar nga burrat që përcaktojnë rregullat e brendshme të partive, paragjykimin e përhapur me bazë gjinore në praktikën e partisë dhe pritshmëri më të larta mbi gratë në poste publike.

Përpjekje domethënëse janë të nevojshme për të nxitur barazi më të madhe gjinore në partitë politike në Maqedoninë e Veriut, përfshirë avokimin e vazhdueshëm për përfaqësim më të mirë politik të grave në strukturat vendimmarrëse të partive politike. Inkurajimi i përfshirjes së anëtarëve meshkuj të partisë në këto përpjekje mund të jetë i rëndësishëm për të arritur mundësi të barabarta për gratë në parti.

Vetë gratë politike duhet të mësojnë se si të fitojnë, mbajnë dhe zgjerojnë kapitalin politik. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive të fjalimeve publike dhe komunikimet digjitale. Partitë politike duhet të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për gratë kandidate dhe përfaqësuese të zgjedhura për të fituar këto aftësi, përfshirë dhe inkurajimin e tyre për të folur në debate publike dhe duke siguruar ose mbështetur trajnime për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.


Administrata zgjedhore

Përbërja gjinore e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve (KSHZ), si organi më i lartë i menaxhimit të zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut, nuk përputhet me dispozitat ligjore që kërkojnë përfaqësimin gjinor të të paktën 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Procesi i propozimit të Komisionarëve shtetërorë të zgjedhjeve duhet të jetë në përputhje me Kodin zgjedhor dhe Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat dhe dispozitat e tij në lidhje me mundësitë e barabarta dhe përfaqësimin gjinor.

Hulumtimi dhe analiza e ndërmarrë për këtë studim tregon se KSHZ duhet të rrisë angazhimin institucional për integrimin gjinor në strukturat dhe aktivitetet e saj, përfshirë sigurimin e pamjaftueshëm të të dhënave të zberthyer sipas seksit në lidhje me pjesëmarrjen e grave në proceset politike dhe zgjedhore.

KSHZ dhe aktorët e tjerë relevantë të përfshirë në administrimin e zgjedhjeve duhet të ndërmarrin të gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar të dhëna të zberthyer sipas seksit në lidhje me të gjitha fazat e procesit zgjedhor.



Ky studim konfirmon se një kuotë gjinore prej 40 për qind për listat e kandidatëve nuk rezulton domosdoshmërisht në përfaqësim prej 40 për qind të grave në këshillat komunale.

KSHZ-ja mund të rishikojë udhëzimin e saj për arritjen e kuotës gjinore prej 40 për qind, për listat e kandidatëve për të përmirësuar në mënyrë plotësuese, mundësitë që gratë të zgjidhen këshilltare.

Plani i fundit strategjik i KSHZ dhe plani i veprimit gjinor ofrojnë bazë afatgjate dhe të nevojshme për angazhimin institucional të duhur lidhur me barazinë gjinore.

Aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit gjinor të KSHZ duhet të zbatohen plotësisht. Këto, duhet të përfshijnë trajnimin e synuar në ndërgjegjësimin gjinor të menaxhmentit dhe stafit. Poashtu, vazhdimi i përpjekjeve për të siguruar të dhëna të zbërthyer sipas seksit, nga KSHZ, për të gjitha aspektet zgjedhore.

KSHZ duhet konsideron strategjitë tjera si dhe kyqjen në partneritete për të mundur përhapjen e mëtutjeshme e të dhënave zgjedhore të zbërthyer sipas seksit përtej publikimit të këtyre të dhënave në faqen e saj të internetit.



Media

Gratë në Maqedoninë e Veriut janë të angazhuara në luftë të pabarabartë për mundësi të barabarta dhe pjesëmarrje të barabartë në proceset politike dhe zgjedhore.

Duhet të bëhen përpjekje për të mbështetur propozimet e praktikuesve të medias të raportuara në këtë studim për integrimin e barazisë gjinore në politikat editoriale dhe për krijimin e mekanizmave të burimeve njerëzore për të monitoruar dhe promovuar përparimin e grave në politikë në media.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, si organi kryesor rregullator i medias në Maqedoninë e Veriut, është e angazhuar për të dokumentuar dhe ballafaquar modelet dhe rastet e portretizimeve stereotipike të grave në mjedisin mediatik.

Kapaciteti i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale duhet të forcohet më tej për të monitoruar fushatat zgjedhore lokale dhe për të kryer trajnim të synuar në ndërgjegjësimin gjinor për gazetarët.

Duhet të bëhen përpjekje më të mëdha nga të gjitha trupat shtetërore përgjegjëse për të monitoruar mediat online në mënyrë më efektive, si në përgjithësi ashtu edhe në mënyrë të veçantë në lidhje me fushatat e mediave online gjatë zgjedhjeve kombëtare dhe lokale.



**SUPPORT TO
ELECTORAL REFORMS**
ПОДДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
МБЕШТЕТЈЕ И РЕФОРМАВЕ ЗГЈЕДНОРЕ

Kjo përmbledhje është pregaditur në suaza të projektit “Mbështetje për reformat zgjedhore” të Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Qëndrimet dhe përmbajtja e shprehur në këtë publikim, nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit, projektit apo realizuesit.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

